



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 4981 Prot.

Roskovec, më 29.09 2020

VENDIM

NR. 69. DATË 28.09. 2020

**“PËR MIRATIMIN E PROCESVERBALIT TË MBLEDHJES SË KËSHILLIT
BASHKIAK PËR MUAJIN GUSHT 2020”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, si dhe Rregullores së Funkcionimit të Këshillit të Bashkisë Roskovec neni 88, Këshilli i Bashkisë,

VENDOSI:

- 1- Miratimin e procesverbalit të mbajtur më datë 28.08.2020, në mbledhjen e Këshillit Bashkiak për muajin Gusht 2020.
- 2- Ngarkohet Sekretari i Këshillit me zbatimin e këtij vendimi.
- 3- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Kadri Hyska





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KËSHILLI BASHKIAK

Adresa: Qendër Roskovec, Web: www.bashkiaroskovec.gov.al

Nr. 4278/1 Prot.

Roskovec, më 31 . 08 . 2020

Procesverbal Nr.8

-I mbajtur sot, date 28.08.2020, ora 11, ne mbledhjen e Keshillit te Bashkise, mbledhje e radhes. Mbledhja po zhvillohet ne sallen e madhe te Pallatit te Kultures, e cila ka hapsire te mjaftueshme per ruajtjen e distancimit fizik te antareve te keshillit. Rendi i dites :

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Informacion mbi Vendimet e Këshillit të mbledhjes së muajit Korrik 2020.
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak.
4. Për dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar deri në 6% për periudhën 1-31 Korrik 2020.
5. Për një ndryshim buxheti për miratimin e fondit për projektet “Tregje publike të sigurta” dhe fondit shtesë në kuadër të projektit Romacted.
6. Për shpronësimin për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken nga projekti “Për ndërtimin e banesave për strehim social, Roskovec”.
7. Diskutime dhe komente të qytetarëve.

Ora e hapjes se mbledhjes: 11¹⁰

Keshilltaret prezent: A. Kola, K. Kuka, V. Mata, E. Çepele, Rr. Hazizi, L. Hoxha, L. Goga, B. Çobo, B. Kuka, K. Hyska, A. Hazizi, V. Bakaj, V. Dogani, A. Sheme, H. Beqiraj, B. Toska, M. Sufka.

Keshilltaret qe mungojne : Tajane Kuka, Dorinela Hoxha, Genci Hoxha, Valbona Stani.

Te pranishem nga administrata e bashkise: Kryetarja M. Bufi, Nenkryetari M. Goga, Dr. Juridike, Dr. Menaxhimi Projekteve Sociale, P/Z/Ndihmes Ekonomike, Dr. Finances, Dr. Urbanistikes, qytetari G. Hoxha.

Me plotesimin e kuorumit, kryetari i keshillit hap mbledhjen. Prezent ne fillimin e mbledhjes 17 keshilltare. Para se te filloje rendi i dites kryetari u ben me dije se per piken nr.6 te rendit sot u ka ardhur lista perfundimtare e pronareve pasi na erdhi konfirmimi i karteles se pasurise nga ASHK-ja. Fillojme me rendin e dites:

1. Miratimi i rendit te dites se mbledhjes.

Hidhet ne votim rendi i dites dhe miratohet unanimitisht me 17 vota pro.

2. Informacion mbi Vendimet e Keshillit te mbledhjes se muajit Korrik 2020.

Sekretarja e keshillit sqaron vendimet.e miratuara ne mbledhjen e kaluar.Sqaron ndarjen e vendimeve ne normative,kolektive dhe individuale,dhe konfirmimin e Prefektures.

3.Miratimi i procesverbalit te mbledhjes se kaluar te Keshillit Bashkiak.

Nuk ka pyetje.Hidhet ne votim procesverbali i mbledhjes se kaluar dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro.

4.Per dhenien e Ndhimes Ekonomike nga fondi i kushtezuar deri ne 6% per periudhen 1-31 Korrik 2020.

Bujari-pyet per Kurjanin,si nuk ka asnje ne 6%?Elmazi-per 6% ka vendim nga qeveria?Elisi i Ndhimes Ekonomike jep sqarime se ligji eshte i njejte si per ndihmen ekonomike.Hidhet ne votim projekti i dhenies ndihme ekonomike nga fondi i kushtezuar 6% dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro.

5.Per nje ndryshim buxheti per miratimin e fondit per projektet “Tregje publike te sigurta” dhe fondit shtese ne kuader te projektit Romacted.

Dr.projekteve sqaron se keto nuk jane fondet tona por nga projekte romacted.Jep sqarime te detajuara.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro sipas materjalit te sjelle nga zyra.

6.Per shpronosimin per interes publik,te pasurive te paluajtshme prone private,qe preken nga projekti “Per ndertimin e banesave per strehim social,Roskovec”

Dr.Delina Hoxha sqaron vendimin e miratuar nga keshilli per lidhjen e marreveshjes me entin e banesave per ndertimin e baneses sociale.Elmazi-personat qe do te shproneshohen cfare zgjidhje u ka dhene bashkia?Delina sqaron se kemi marr konfirmimin nga ASHK,ju kemi derguar njoftim per dokumenta pronesie qe disponojne,lame dhe degjese publike.Kryetarja sqaron se enti i banesave kriteri i pare kerkon truallin ne emer te bashkise,fondi eshte totalisht i tyre.Nisur nga problematikat ne morem vendim pa percaktim sheshi.Ka shume kerkesa per banesa nga familjet e pastreha.Nga verifikimi qe kemi bere te gjithe territorit,ne kemi pare si zgjidhje te ndertimit te 1 apo 2 ndertesave tek ish-SMT.Me ligj kostoja per shpronosimin eshte vetem trualli,dhe u perket bashkepronareve Resuli.Ka dhe te tjere qe aty ushtrojne veprimtarine e tyre por nuk e kane te certifikuar.Moralisht ne si bashki do u ofrojme nje mundesi te dhenies se tokes me qera qe ata ta ushtrojne veprimtarine e tyre ne keto toka.Mundesia tjeter-mund te marim godinat e vjetra te Albpetrolit.Qytetit nuk mund tja ndalim dot zhvillimin.Aktiviteti qe ata kane mund te behet edhe ne zonen e Marinzes.Ne baze te ketij vendimi ne lidhim marrveshje me Entin e Banesve.Jemi ne rrugen e duhur qe edhe investimi per dy pallate nuk eshte keq,ne sistemojme nje pjese te mire te familjeve qe jane te pastreha,kryesisht dhe te rinjt.Konfirmimin e ASHK ne e kemi marr per pjesen e truallit.Preket nje siperfaqe e lire e truallit ne krahe te SMT-se dhe godina e SMT-se.Leksi-eshte gje e mire qe nuk preken qytetaret,e dyta qe dhe per ata qe ushtrojne aktivitet eshte gjendur zgjidhja,dhe te ndertohet me ritme te shpejta per shtresen sociale qe jane te pastreha.Jam dakort qe te kaloje ky projekt-vendim.Elmazi-te kthehemi nga ata qe preken,jane disa familje qe punojne ne ate godine,qe ushqehen.Me vjen mire qe bashkia ka menduar zgjidhje edhe per keto familje.Jam plotesisht dakort qe ajo te kaloje prone e bashkise ne te mire te familjeve qe jane te pastreha.Kryetarja-edhe per bllokun Nr.2 ne ua kemi ofruar mundesine e zgjidhjes per ti sistemuar diku tjeter te gjitha bizneset qe prekeshin nga blloku Nr.2.Une jam e gatshme ti sistemoje.Hidhet ne votim projekti dhe miratohet unanimisht me 17 vota pro(3/5+4) vota pro shpronosimi i pasurive te paluajtshme prone private,sipas listes se pronareve te sjelle sot,te cilet preken nga projekti “Per ndertimin e banesave per strehim social,Roskovec” si dhe vlera perkatese e shpronosimit.

7.Diskutime dhe komente te qytetareve.

Nje qytetar Gezim Hoxha ka problem me shtepine,u prish shtepia dhe u be marrveshja,ka arritur deri ne tulla.Ka problem me nenen e tij,nese ka bashkia mundesi te veri dore qe te perfundoje shtepia.Kryetarja e sqaron,kemi edhe nje investim tjeter,por nuk e di nese eshte emri apo jo,do shoh listen,por nuk futen 2 here nje familje.Elmasi-ajo ka vendosur nje cader,mu dhimbs kur e pashe atje,i thirra Gezimit e pyeta si ka perfunduar ashtu?Po vjen dimri duhet te gjejme nje zgjidhje.Lista eshte bere per kete vit-sqaron kryetarja,Gezimi e ka mar investimin qe vjet.Leksi-ka mundesi te ndihmohet?te kishin nje menaxhim me te mire nga familjaret.Leksi-te perroi i Vidhishtes po behet nje pastrim shume i mire,por ka qytetare te pandergjegjshem qe po hedhin mbetje inerte,ka ndonje punonjes qe eshte ne ruajtje dhe te veri masa penalizuese?Nga bordura e trotuarit deri te pllakat kemi nje ndarje goxha te madhe,ka trotuare qe kur bie shi nuk kalon dot as me cizme.Vera-pyet per nje qytetar qe se ka mar akoma kompensimin e lindjes se femijes te vitit 2016.Kryetarja e sqaron se fondi vjen gjithmone me vonese,do besh verifikimin te financa per emrin ne liste.Leksi pyet per pjesen e tregtareve qe shesin para tek banka fruta-perime,ka ankesa.Aleksandri-tek lagja ime pjesa ku do kaloje unaza,ka shume ferra dhe e kemi te pamundur te kalojme ne kembe.Nese ka mundesi te pastrohen.Nuk ka me diskutime.Kryetari mbyll mbledhjen.

Sekretar

Arlinda Hajdini



Kryetar

Kadri Hyska

